



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"**

Në bazë të Nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me datë: 26.07.2023, U.d. Sekretari i Përgjithshëm me datë 19.11.2024, nxjerr:

**V E N D I M**

- I. Miratohet Plani i Integritetit të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë për vitet 2024-2026, i hartuar nga Grupi Punues, i caktuar me Vendimin nr. 2194 datë 29.08.2023.
- II. z. Armend Alimusaj – zyrtar për paga, caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

**Arsyetim**

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), në raport me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale për miratimin e Planeve të Integritetit.

Në kuadër të kësaj, sipas udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit të Metodologjisë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me datë: 26.07.2023, U.d. Sekretari i Përgjithshëm nxjerr vendim për miratimin e Planit të Integritetit, të hartuar nga grupi punues, i caktuar me Vendim nr. 2194 datë 29.08.2023, të theksuar si në pikën 1 të dispozitivit të Vendimit.

z. Armend Alimusaj, sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit. I cili monitoron procesin sipas planit të integritetit, zbatimin e masave të përmirësimit nga institucioni, përgatit treguesit për vlerësimin e efikasitetit dhe vlerësimin e rezultateve të masave të propozuara për përmirësimin e integritetit.

Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme

L.M. Tirona Baffiu Hasani



**Vendimi t'i dërgohet:** Anëtarëve të Grupit Punues; Personit përgjegjës për monitorim; Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit; Arkivës së UHZ-së.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"**

Adresa; Rruga e UÇK-së, 30000 Pejë, Republika e Kosovës, Nr. tel + 383 39 432 270, info@unhz.eu

**PLANI I INTEGRITETIT 2024-2026 NË UNIVERSITETIN "HAXHI  
ZEKA" NË PEJË**

Pejë, Nëntor 2024

## PËRMBAJTJA

Lista e Shkurtesave.....	3
Deklarata e Integritetit Institucional.....	4
HYRJE.....	5
FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.....	6
PLANI I INTEGRITETIT.....	6
PROCESI I HARTIMIT TË PLANITË INTEGRITETIT.....	8
METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË RREZIKUT.....	9
MONITORIMI DHE RAPORTIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT.....	12
RISHIKIMI.....	13
FUSHAT E RREZIKUT .....	13
PYTËSORI .....	14
SHTOJCA - Matrica e vlerësimit të rrezikut në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë.....	15

## Lista e Shkurtesave

<b>UHZ</b>	Universiteti "Haxhi Zeka" Pejë
<b>NJMBNJ</b>	Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

## Deklarata për Integritet Institucional

Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë ka arritur një moment vendimtar duke miratuar, për herë të parë, një plan të integritetit, si një institucionin serioz i arsimit të lartë në Kosovë që ndërmerr hapat e nevojshëm për të forcuar integritetin institucional. Kjo nismë shënon një hap të rëndësishëm drejt identifikimit të rreziqeve dhe zbatimin e masave të nevojshme për të përmirësuar nivelin e integritetit.

Përmes përcaktimit të rregullave, procedurave dhe forcimit të mekanizmave të monitorimit, Universiteti synon të parandalojë korrupsionin dhe shkeljet tjera që mund të rrezikojnë integritetin e tij. Ky plan synon të theksojë vlerat e pranuar në mënyrë të përbashkët dhe të ndërtojë imazhin e Universitetit si një institucion i rëndësishëm për komunitetin.

Plani i integritetit është një mjet për të ndërgjegjësuar të gjithë palët e interesuara për politikën dhe procedurat e etikës dhe për të vendosur standarde të larta për sjelljen në Universitet. Ne si institucion i arsimit të lartë angazhohemi në përmirësimin e kapaciteteve profesionale dhe përcaktimin e politikave dhe procedurave të qarta për të garantuar zbatimin e standardeve të integritetit.

Besojmë se vetëm me përkushtimin e përbashkët të të gjithë palëve të interesuara, përfshirë menaxhmentin, stafin akademik, stafin administrativ, studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm, mund të arrijmë qëllimin tonë për të ruajtur integritetin e Universitetit.

Plani ynë për integritet synon gjithashtu të ndërtojë besimin e publikut dhe të forcojë imazhin e Universitetit si një institucion i besueshëm dhe i përgjegjshëm në arsimin e lartë.

## 1. HYRJE

Në përputhje me dispozitat e nenit 25 të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në bazë të detyrimeve të paraqitura në "Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsionit", të cilat vendosin përgjegjësinë për zhvillimin dhe miratimin e planeve të integritetit nga të gjitha institucionet, Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë ka përgatitur dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2024-2026. Kjo është hera e parë që Universiteti "Haxhi Zeka" harton një plan të tillë, duke e konsideruar atë si një mjet për të vendosur dhe vlerësuar integritetin institucional.

Procesi i hartimit të planit është realizuar duke u bazuar në dokumentacionin brendshëm të Universitetit dhe duke përdorur metodologjinë e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vlerësimin e nivelit të rrezikut të korrupsionit dhe praktikave të pandëshkuara. Plani është një dokument operativ që përfshin masat specifike për të adresuar rreziqet dhe për të arritur objektivat e integritetit të Universitetit. Në veçanti, Plani synon të fuqizojë kontrollet operative në të gjitha sferat e veprimtarisë së Universitetit duke përfshirë pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e gjerë me palët e interesit, siç janë Menaxhmenti i Universitetit, Stafi Akademik, Stafi Administrativ dhe Teknik, Studentët, Studentët e Diplomuar, Komuniteti i Biznesit, Autoritetet Qeveritare Lokale dhe Qendrore, si dhe Komuniteti Akademik dhe Shkencor jashtë Universitetit.

Plani përmban qëllimet dhe objektivat e qarta, duke identifikuar masat specifike për të luftuar korrupsionin dhe për të forcuar integritetin. Përmirësimi dhe rishikimi i Planit pritet të bëhet një vit pas miratimit, për të përshtatur atë me zhvillimet dhe nevojat e Universitetit. Përmes zbatimit të Planit të Integritetit, Universiteti synon të shtojë efikasitetin dhe transparencën në të gjitha veprimtaritë e tij, duke përmirësuar integritetin institucional. Plani gjithashtu parasheh fuqizimin e mekanizmave për luftimin e korrupsionit dhe për të krijuar një ambient ku të gjithë pjesëmarrësit në Universitet të angazhohen në zbatimin e integritetit. Universiteti përkushtohet në rritjen e besimit të publikut dhe palëve të interesit në përputhje me këtë Plan të Integritetit.

## 2. FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Me vendimin ref. nr. 2194/23, datë 29.08.2023, të ud. Sekretarja e Përgjithshme të Universitetit "Haxhi Zeka", është formuar një grup punues për hartimin e Planit të Integritetit për institucionin e lartpërmendur.

Gjatë procesit të hartimit të planit, grupi punues ka ndjekur udhëzimet dhe metodologjinë e Planit të Integritetit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit. Analiza ka përfshirë dokumentacionin ligjor brendshëm të Universitetit, duke përfshirë Statutin, rregulloret dhe vendimet e tij, për të vlerësuar rrezikun e korrupsionit dhe format e tjera të sjelljes që mund të ndikojnë në integritetin e institucionit. Përveç kësaj, janë zhvilluar intervista me përfaqësues të institucioneve si Zyra e Financave dhe Burimeve Njerëzore, Zyra e Teknologjisë së Informacionit, si dhe me studentë, të cilët kanë dhënë një kontribut të konsiderueshëm në furnizimin me informacione për hartimin e planit. Në të njëjtën kohë, janë mbledhur të dhëna sasiore përmes një sondazhi i cili ka përfshirë çështje specifike të integritetit në Universitet.

## 3. PLANI I INTEGRITETIT

Plani i Integritetit është një dokument jo vetëm strategjik, por edhe operacional, që konsiderohet si një mjet thelbësor për të formuar integritetin institucional. Ky plan konsiderohet si një angazhim i drejtpërdrejtë për respektimin e vlerave morale, standardeve profesionale, dhe rregullave normative të aplikueshme. Gjithashtu, ai ofron masa të mbështetura për të adresuar rreziqet në përputhje me objektivat e integritetit të Universitetit.

### 3.1. Plani për Integritet mundëson:

- Identifikimin e rreziqeve të korrupsionit përkatëse të korrupsionit në fusha të ndryshme të punës;
- Vlerësimin e çdo lloji rreziku potencial që mund të paraqesë korrupsion;
- Përcaktimin e masave për të reduktuar ose eliminuar rreziqet e korrupsionit.

### 3.2. Plani i Integritetit pritet të kontribuojë në:

- Rritjen e mundësive për të arritur objektivat organizative duke menaxhuar proaktivisht rrezikun e integritetit, duke krijuar një rezistencë organizative ndaj korrupsionit dhe duke zvogëluar ose eliminuar mundësitë për korrupsion;
- Përqendrimin në prioritetet bazuar në identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut, duke përdorur burimet e disponueshme efektivisht për të luftuar korrupsionin;
- Përmirësimin e kontrolleve operative për të rritur efektivitetin, efikasitetin, dhe transparencën në të gjitha proceset, duke përfshirë shërbimet ndaj studentëve;

- Sigurimin e pajtueshmërisë me kërkesat ligjore dhe procedurale të përshtatshme;
- Krijimin e një mjedisi të favorshëm kundër korrupsionit duke trajnuar dhe ndërgjegjësuar, dhe duke inkurajuar pjesëmarrjen e të gjithë stafit në zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve të integritetit;
- Rritjen e besimit të palëve të interesit brenda dhe jashtë institucionit në përkushtimin e Universitetit për integritet.

Zbatimi i Planit të Integritetit do të pozicionojë Universitetin në një nivel më të lartë për të siguruar efikasitet, efektivitet, transparencë, dhe etikë gjatë arritjes së synimeve të tij. Ky plan është bazuar në një përgatitje të plotë dhe në një proces të vetëvlerësimit të rrezikut të Universitetit.

### 3.3. Struktura e Planit të Integritetit

Ky Plan Integriteti parasheh masa që ndikojnë në reduktimin e rrezikut të korrupsionit dhe formave tjera të cenimit të integritetit, gjatë proceseve të ndryshme të punës brenda institucionit, të përcaktuara me kolona për futjen e të dhënave në lidhje me sa vijon:

Fusha e rrezikut:

- Përshkrimi i rrezikut;
- Masat ekzistuese të kontrollit dhe efikasiteti i tyre në tejkalimin e rreziqeve;
- Rezultatet e vlerësimit të pasojës dhe probabiliteti i shfaqjes së rrezikut;
- Masat e parashikuara për eliminimin/zvogëlimin e rrezikut;
- Personin përgjegjës për zbatimin e masave;
- Afatin për zbatimin e masave.

### 3.4. Objektivi i Planit të Integritetit është:

- Thjeshtësimi ose eliminimi i procedurave të ndërlikuara dhe të panevojshme;
- Parandalimi i situatave të konfliktit të interesit;
- Ndërgjegjësimi për rreziqet e korrupsionit dhe sensibilizimi i Stafit Akademik, Stafit Administrativ dhe Studentëve për rolin e tyre në zvogëlimin dhe eliminimin e korrupsionit dhe sjelljeve jo etike;
- Përmirësimi i raportimit të rasteve të korrupsionit;
- Monitorimi i transparencës në punë;
- Sjellja etike e menaxherëve dhe punonjësve në Universitet;
- Vendosja e standardeve;
- Krijimi i një sistemi më efikas të kontrollit të brendshëm;
- Eliminimi i praktikave që nuk përputhen me rregulloret;
- Kultivimi i një kulture organizative me përgjegjshmëri;
- Nxitja dhe promovimi i sjelljes etike të punonjësve;



- Përmirësimi i efikasitetit në ofrimin e shërbimeve ndaj studentëve dhe të tjera.

### 3.5. Qëllimi i Planit të Integritetit është:

- Identifikimi i proceseve të ndjeshme ndaj sjelljeve dhe veprimeve që mund të jenë korruptive;
- Sistem efektiv i menaxhimit të integritetit në institucion, që synon respektimin e kërkesave ligjore, procedurale dhe kuadrit të brendshëm normativ;
- Llogaridhënie publike dhe transparencë për të siguruar rritjen e besueshmërisë publike në qeverisjen dhe në performancën e integritetit të sektorit publik;
- Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit, përmes përmirësimit të kontrolleve operacionale në fushat e funksionimit të institucionit dhe proceset e punës me rrezik korrupsioni;
- Planifikim i menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në institucion, me fokus në fushat me rrezik të lartë të cenimit të integritetit, duke synuar integrimin e këtij procesi në kulturën institucionale.

## 4. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

Plani i Integritetit është një dokument që vlerëson integritetin e punës, integritetin institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si institucioni dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve, ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe / ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

- Regjistrimi i rreziqeve të identifikuar dhe të vlerësuara për të gjitha fushat e funksionimit të Universitetit.
- Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zvogëluar rreziqet e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e masave.

Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit është bërë vlerësimi i rreziqeve së integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të Universitetit. Të gjithë të punësuarit kanë pasur mundësi të marrin pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të Universitetit dhe të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit, si dhe ofrimin e shërbimeve.

## Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë , konsistoi në zbatimin e fazave të mëposhtme:

- **Themelimi i grupit të punues për hartimin e Planit të Integritetit** – u.d. Sekretarja e Përgjithshme e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, ka caktuar me vendim nr.2194/23 grupin punues , ku në grup punues janë përfshirë stafi akademik dhe stafi administrativ, si dhe personin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit.
- **Grupi punues për hartimin e Planit të Integritetit** – Ky grup ka bërë mbledhjen e informacioneve të nevojshme për zhvillimin e planit të integritetit, si dhe njoftimin e të gjithë punonjësve për rëndësinë e Planit të Integritetit.
- **Identifikimi dhe analiza e riskut** - Grupi punues ka shqyrtuar kornizën ligjore (Statutin e Universitetit, rregulloret, Planin Strategjik 2020-2024, si dhe burime të tjera informacioni për fushat dhe proceset e punës. Grupi punues ka përpiluar pyetëtorin gjithëpërfshirës, si dhe ka realizuar intervista me qëllim të përpunimit të sondazhit të vetëvlerësimit. Mbi bazën e rezultatit të pyetëtorit, janë përcaktuar fushat e rrezikut dhe identifikimi i rreziqeve.
- **Vlerësimi i risqeve të integritetit** - Grupi punues i ka përdorur të dhënat e siguruara për t'i përpiluar tabelate rrezikut dhe të adresojë cenueshmërinë e integritetit dhe ka propozuar masat për përmirësim.
- **Tabelat e rrezikut** – Grupi i punës duke përdorur të dhënat e siguruara ka përpiluar tabelat e rrezikut për menaxhimin e risqeve të integritetit në institucion, dhe ka propozuar masat për përmirësim Masat përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e tyre. Zbatimi i këtij Plani Integriteti është parashikuar për periudhën 2024-2027.

## 5. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË RREZIKUT

Metodologjia e vlerësimit të rrezikut është një proces i strukturuar që ka për qëllim të identifikoj, vlerësoj dhe menaxhoj rreziqet potenciale në një institucion.

Vlerësimi i rrezikut do të thotë renditja e rreziqeve më të mëdha në krye të listës, që paraqesin efekte thelbësore në integritetin e Universitetit dhe mund të rrezikojnë efikasitetin, besueshmërinë dhe imazhin e Universitetit. Kjo duhet të jetë baza për përcaktimin e masave për trajtimin e rrezikut. Prandaj, prioritetet përcaktohen ashtu që resurset e kufizuara në dispozicion për trajtim, mund të vendosen aty ku vërehet

se janë më të nevojshme. Në përgjithësi, rreziqet e kategorizuara si të vogla, përputhen me standardet për marrje të rrezikut dhe nuk imponojnë nevojën për masa shtesë të trajtimit, por kërkojnë monitorim të efikasitetit të masave ekzistuese të trajtimit/kontrollit. Në anën tjetër, rreziqet madhore kërkojnë trajtim të menjëhershëm me masat adekuate.

Pas përcaktimit të dy parametrave, gjasave të ndodhjes së rrezikut dhe pasojave (ndikimit) të rrezikut të ndodhur, grupi punues ka përcaktuar nivelin e rrezikut për të gjitha rreziqet e identifikuar dhe të vlerësuara, duke përdorur Matricën e Rrezikut. Niveli përfundimtar i rrezikut është përcaktuar duke u bazuar në Matricën e Rrezikut si kombinim i gjasave dhe pasojave.

### 5.1. Matrica vlerësimit të rrezikut

Matrica e vlerësimit të rrezikut mundëson të llogaritet rreziku në një fushë, për një kohë shumë të shpejtë, duke identifikuar të gjitha gjërat që mund të shkojnë keq dhe duke peshuar dëmin e mundshëm. Kjo e bën më të lehtë prioritizimin e çështjeve dhe ndërmarrjen e veprimeve, masave aty ku është më e nevojshme.

Figura 1 . Matrica e vlerësimit të rrezikut




Pasoja /Ndikimi	Madhor	10																		
		9																		
		8																		
	Mesatar	7																		
		6																		
		5																		
		4																		
	Vogël	3																		
		2																		
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10									
Intenziteti i rrezikut (gjasat X ndikimi)		Ulët			Mesatar				Lartë											
		Probabiliteti/Gjasat																		

Intensiteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lartë

## 5.2. Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të dëmtimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 – 15 pikë	16 - 48	49 - 100

-  Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.
-  Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.
-  Rreziku me intensitet të lartë – Korrupsioni ose format e tjera të dëmtimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

## 5.3. Prioriteti i rreziqeve

Prioriteti i rrezikut nënkupton renditjen e rreziqeve të integritetit, duke filluar nga rreziqe më parësore që paraqesin ndikim thelbësor në integritetin e institucionit dhe që mund të rrezikojnë efektshmërinë dhe reputacionin e tij, deri te rreziqet e ulëta të cilat nuk mund të kenë nevojë për masa, por mjafton të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.

Renditja e rreziqeve bëhet sipas rëndësisë, dhe përfshin vlerësimin midis mundësisë së ndodhjes apo shfaqjes së një rreziku dhe ndikimit të tij në integritetin e institucionit.

## 6. MONITORIMI DHE RAPORTIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të organizatës. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në projektim ashtu edhe në funksionim, dhe se procedurat janë kuptuar si dhe plani integriteti është ndjekur.

Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë eficiente, nëse kanë evidentuar ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioritetëve të risqeve, si edhe nxjerrjen e mësimëve për planifikim më të mirë në të ardhmen.

Gjithashtu monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e riskut kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioritetëve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësimë duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen. Raportimi i rregullt, siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur.

Me qëllim të sigurimit të zbatimit të planit të integritetit, me vendimin Nr. Prot. 01-595, të datës 27.09.2023, është emëruar edhe personi përgjegjës për raportimin e zbatimit të Planit të Integritetit.

Personi përgjegjës për raportimin e zbatimit të Planit të Integritetit është përgjegjës për:

- Përgatitë metodologjinë për monitorimin e Planit të Integritetit konformë metodologjisë për planet e Integritetit nga UHZ;
- Të mbledhë dhe analizon dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me zbatimin e masave;
- Harton raporte periodike dhe vjetore (çdo 6 muaj) për monitorimin e zbatimit të planit të integritetit dhe i raporton, Sekretarit të Përgjithshëm të UHZ-së, dhe Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Të gjithë punonjësit janë të detyruar të informojnë personin përgjegjës për situatën, veprimet, masat për të cilat ata janë të angazhuar për veprim.

Të paktën një herë në vit, me kërkesë të titullarit, personi përgjegjës duhet të paraqesë një raport për zbatimin e planit të integritetit.

#### **6.1. Raportimi duhet bërë mbi zbatimin e masave në mënyrën si më poshtë:**

- Masa është zbatuar në kohën e duhur;
- Masa është zbatuar pas afatit;
- Masa është zbatuar në mënyrë periodike.

Për masat që nuk janë zbatuar, përgjigjet e mundshme do të jenë si më poshtë:

- Masa nuk është zbatuar për shkak të menaxhimit joadekuat të procesit;
- Masa nuk është zbatuar për shkak të menaxhimit joadekuat të institucionit;
- Masa nuk është zbatuar për shkak të mungesës së burimeve njerëzore;
- Masa nuk është zbatuar për shkak të mungesës së buxhetit;
- Masa nuk është zbatuar për arsye të tjera;
- Masa nuk është zbatuar për shkak se ende nuk është arritur afati për zbatimin e masës.

## **7. RISHIKIMI**

Rishikimi i Planit të Integritetit bëhet çdo vit, në përputhje me Ligjin, neni 25.5 duke marrë në konsideratë rezultatet e zbatimit të masave të propozuara për reduktimin e rrezikut. Ky plan i integritetit është i hapur për përshtatje dhe përmirësim bazuar në feedback-in dhe nevojat e komunitetit universitar të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë . Ne angazhohemi për të ruajtur standardet më të larta të integritetit akademik dhe për të ndërtuar një mjedis ku dija dhe sinqeriteti vlerësohen dhe përhapen. Ky plani i integritetit mund të përshtatet dhe përshkruhet më tej në përputhje me nevojat dhe specifikat e institucionit.

## **8. FUSHAT E RREZIKUT**

### **8.1. Fushat e përgjithshme të rreziku**

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Sjellja Etike dhe Profesionale;
- Menaxhimi i Financave Publike;
- Ruajtja dhe Siguria e të Dhënave dhe Siguria e Teknologjisë së Informacionit;
- Transparenca e Organeve Vendimmarrëse.

## 8.2. Fushat specifike të rrezikut

- Sigurimi i Cilësisë;
- Ngritja e Cilësisë në Mësimdhënie dhe Mësimnxënie;
- Digjitalizimi dhe Përmirësimi i Infrastrukturës;
- Auditimi i Brendshëm;
- Menaxhimi i Kontratave Publike;
- Menaxhimi i Pasurisë Jo Financiare.

## 9. PYTËSORI

Në kuadër të zhvillimit të Planit të Integritetit, UHZ ka krijuar pyetëSORIN Online ku i njëjti është dërguar tek stafi akademik dhe administrativ i Institucionit. Nga të dhënat që kanë dal nga ky pyetësor, del që UHZ qëndron mirë në aspektin organizativ dhe përgjegjësive të ndara në njësi organizative. Rezultatet e marra nga pyetësori i zhvilluar janë pasqyruar kryesisht edhe në Fushat e Përgjithshme të Rrezikut dhe Fushat e Veçanta të rrezikut.

FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT

Identifikimi i rrezikut		Intensiteti i rrezikut			Masat ndaj rrezikut		Afati i realizimit		
Nr.	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i rrezikut	Masat ekzistuese kontrollit ekzistuese	Gjasat të rrezikut	Ndiki i rrezikut	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	
1.	Politikat menaxhuese dhe qartësi i detyrave dhe përgjegjësi të pozitave dhe përgjegjësi të pozitave të caktuara	Politikat menaxhuese dhe qartësi i detyrave dhe përgjegjësi të pozitave dhe përgjegjësi të pozitave të caktuara ose paplotë, duke çuar në konfuzion, ndërprerje të punës, dhe menaxhim të dobët të burimeve. Kjo mund të rezultojë në shkelje të politikave dhe procedurave, si dhe në	Statuti Universitetit, Rregullojta për Përkrahimin e Detyrave të Punës Personelin Administrativ.	5	5	25	<p><b>Revizion dhe përmirësim i politikave menaxhuese:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Auditimi dhe përditësimi: Duhet të Rishikoni politikat dhe procedurat ekzistuese për të siguruar që ata janë të qarta dhe të përshatshme për nevojat e universitetit.</li> </ul> <p><b>Krijimi i dokumentacionit të qartë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Duhet të sigurohet që dokumentacioni të jetë i qartë dhe i aksesueshëm për të gjithë stafin. Ndihejmon në krijimin e një manuali të politikave dhe procedurave që përshkruan detajet e sakta për rolet dhe përgjegjësitë.</li> </ul> <p><b>Trajnimi dhe informimi i stafit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Trajnime periodike: Duhet të ofrohen trajnime të rregullta për stafin për të siguruar që ata janë të njohur me politikat dhe procedurat dhe e kuptojnë rolin e tyre dhe përgjegjësitë.</li> <li>Komunikimi i qartë: Siguroni që çdo ndryshim në politikat ose procedurat të komunikohen qartë dhe në mënyrë të menjëhershme për të parandaluar konfuzionin dhe moskuptimet.</li> </ul> <p><b>Përcaktimi dhe monitorimi i përgjegjësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Definimi i qartë i detyrave: Duhet të krijohen dhe dokumentohen detyrat dhe përgjegjësitë e çdo pozite në mënyrë të qartë. Përcaktoni gjithashtu përgjegjësitë për mbikëqyrjen dhe raportimin e aktiviteteve.</li> </ul>	Këshilli Drejtues, Rektori, Sekretari i Përgjithshëm	2025



	irritje mundësisë për abuzime ose praktika të papërshtatshme.					<ul style="list-style-type: none"> <li>Kontroll i rregullt: Implementoni mekanizma për të monitoruar dhe vlerësuar përmbushjen e detyrave dhe për të identifikuar ndonjë problem të mundshëm në mënyrë të shpejtë.</li> </ul> <p><b>Implementimi i një sistemi për raportimin dhe menaxhimin e ankesave:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Sistemi i raportimit të ankesave: Krijoni një sistem të besueshëm dhe të sigurt për raportimin e ankesave dhe shkeljeve të mundshme. Siguroni që ky sistem të jetë i qasshëm për të gjithë stafin dhe të ofrojë mbrojtje për ata që raportojnë shqetësime.</li> </ul>		
2.	Respektimi i rregullorve të punës nga të gjithë personeli i UHZ-së.	që indërlidhet me respektimin e rregullorve të punës nga të gjithë personeli i UHZ-së.	Kodi i Etikës 5 për stafin Akademik, Kodi i Etikës për Stafin Administrativ, Rregullorja për punëtorët dhe procedurën disiplinore për Stafin Haxhi Zeka Akademik, Rregullorja për mosrespektimin dhe këtyre rregullorve të Administrativ.	7	35	<p>Për të zvogëluar ose eliminuar rreziqet që lidhen me respektimin e rregullorve të punës nga i gjithë personeli i Universitetit Haxhi Zeka në Pejë, mund të parashikoni disa masa proaktive. Këtu janë disa masa që mund të merrni parasysh:</p> <p><b>Edukimi dhe Trajnimi:</b></p> <p>Organizimi i Trajnimeve të Rregullta: trajnimet duhet të jenë të nevojshëm për të gjithë stafin në lidhje me rregullorët e punës dhe politikat e universitetit.</p> <p>Krijimi i Materialeve Edukative: Përgatija e broshurave, manualeve dhe guidave për rregullorët e punës që janë të lehta për t'u kuptuar dhe të aksesueshme për të gjithë.</p> <p><b>Implementimi i Kontrollit dhe Monitorimit:</b></p> <p>Rishikimi/Krijimi i Një Sistemi të Monitorimit: Vendosja e mekanizma për të monitoruar përputhshmërinë me rregullorët e punës. Kjo mund</p>	Në vazhdimësi	

	pasojash negative që ndikojnë në funksionimin e efikas dhe të ndershëm të Universitetit.	<p>të përfshijë auditime të rregullta dhe raporte periodike.</p> <p><b>Vendosni Masa Disiplinore:</b> Duhet të definohen qartë pasojat për shkeljet e rregulloreve.</p> <p><b>Përmirësimi i Komunikimit dhe Transparencës:</b> Duhet të krijohen kanale të qarta të komunikimit. Duhet të sigurohet që stafi të ketë mundësi të raportojë ankesat ose shqetësimet për shkelje të rregulloreve në një mënyrë të sigurt dhe të konfidenciale.</p> <p><b>Rishikimi i Rregulloreve:</b> Rishikoni dhe përditësoni rregulloret dhe procedurat për të siguruar që ato të jenë të përshtatshme dhe të përmbushin kërkesat e kohës.</p> <p><b>Promovimi më i madhe i Vlerave Etike:</b> Duhet të nxihet më shumë zhvillimin e një kulture etike dhe të përgjegjshme në universitet, duke theksuar rëndësinë e respektit për rregulloret dhe normat e sjelljes.</p>	
--	--	--	--